



Republika e Kosovës  
*Republika Kosovo - Republic of Kosovo*



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës  
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova  
Civil Aviation Authority of Kosovo

**RAPORT MBI  
KONSULTIMIN PUBLIK TË PALËVE TË INTERESIT  
NR. 19/2017**

19 Dhjetor 2017

## I. TË PËRGJITHSHME

Ky raport është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesit, lidhur me projekt-rregulloren e AAC-së, si në vijim:

Regullore nr. 19/2017 mbi përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror.

Kjo projekt-rregullore ka qenë në procedurë të konsultimit publik sipas kërkesave të nenit 5, pika 5.2 e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012, përkatësisht nga data 14 deri me 29 Nëntor 2017.

Neni 5, Pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 thotë që: “AAC-ja do të aplikojë procedura transparente për konsultimit publik të palëve të interesuara nëpërmes:

- a) Metodës së pranimit të komenteve dhe vërejtjeve me shkrim me anë të mjeteve elektronike të komunikimit (adresë elektronike zyrtare) apo dorëzimit të tyre personalisht ; dhe/ose
- b) Organizimit të takimeve publike me palët e interesuar”

Në pamundësi të organizimit të takimeve publike me palët e interesuara, konsultimi publik u realizua sipas pikës 5.1, a) të udhëzimit të lartëcekur.

## II. KOMENTET E PRANUARA DHE PËRGJIGJET E AAC-së

Në thirrjen e dërguar për konsultim publik të palëve të interesit nuk janë paraqitur vërejtje/sugjerime në lidhje me rregulloren e cila ka të bëjë me përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror.

## III. PËRFUNDIM

Gjatë fazës së konsultimit publik të palëve të interesit lidhur me projekt-rregulloren nuk ka pasur asnjë koment nga palët e konsultura dhe si rrjedhojë nuk ka pasur nevojë për komentim shtesë nga ana e AAC-së. Si e tillë rregullorja në fjalë plotëson kushtet për tu futur në fuqi.

**Raporti është hartuar nga:**

Departamenti i Shërbimeve të Navigacionit Ajror